




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen Prioritetet Kyçe të Agjendës Evropiane për vitin 2018.
2. Obligohen Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga Prioritetet Kyçe të Agjendës Evropiane për vitin 2018, sipas fushave në të cilat janë përgjegjëse bazuar në Shtojcën 1. të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZIBA E Kryeministrit - Ured Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i protokollit Prot. No. 02/01	Nr. Prot. 3217 Prot. No.
Kategoria No. 92	Data: Date: 16.11.2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PRIORITETET KYÇE TË AGJENDËS EVROPIANE PËR VITIN 2018

Nëntor 2017
Prishtinë

I. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit

Një nga sfidat më të mëdha për Kosovën është sektori i sundimit të ligjit me një numër çështjesh të përsëritura siç është pavarësia e gjyqësorit, korrupsioni etj.

Për prioritetet e vitit 2018 në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Sundimi i ligjit

- Miratimi i legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion
 - *Ministria e Drejtësisë, Qeveria (30 shtator 2018)*
- Miratimi i Ligjit për Konfliktin e Interesit
 - *Kuvendi (30 mars 2018)*
- Miratimi i Ligjit për Prokurorin e Shtetit
 - *Ministria e Drejtësisë, Qeveria (30 mars 2018)*
- Miratimi i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë
 - *Ministria e Drejtësisë, Qeveria (30 mars 2018)*

2. Reforma zgjedhore

- Përgatitja e pakos ligjore për reformën zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesa për opinion nga Komisioni i Venedikut
 - *Kuvendi (30 shtator 2018)*
- Përgatitja e Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe kërkesa për opinion nga Komisioni i Venedikut
 - *Zyra e Kryeministrit (30 shtator 2018)*
- Përfundimi i auditimit të financave të partive politike
 - *Kuvendi (30 qershor 2018)*
- Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj
 - *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (30 shtator 2018)*

3. Reforma e administratës publike

- Zbatimi i Planit për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë
 - *Zyra e Kryeministrit, Kuvendi (30 shtator 2018)*
- Sigurimi i një procesi transparent, të bazuar në merita dhe jopolitik të përzgjedhjes, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullatorë, si dhe në kompanitë publike
 - *Zyra e Kryeministrit (30 shtator 2018)*
- Miratimi i pakos ligjore për Reformë të Administratës Publike
 - *Ministria e Administratës Publike, Qeveria (30 qershor 2018)*

II. Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve

Kosova është ekonomi e vogël e bazuar në konsum, e mbizotëruar nga sektori i shërbimeve, me integrim të kufizuar ndërkombëtar dhe varshmëri të lartë në asistencën nga donatorët dhe remitencat. Deficiti tregtar është shumë i lartë (2.47 miliardë euro në vitin 2015), me bazë prodhimit mjaft të ngushtë dhe ende jo-konkurruese. Dobësitë strukturore kufizojnë zhvillimin ekonomik afatgjatë të Kosovës, duke përfshirë krijimin e tregut funksional të punës ku do të ofroheshin më tepër mundësi punësimi. Ndër sfidat kryesore për Kosovën janë nevojat për ngritjen e bazës së saj të prodhimit, zhvillimi i kapaciteteve eksportuese dhe mbyllja e boshllëkut të konkurrueshmërisë, trajtimi i ekonomisë joformale dhe përmirësimi i mjedisit afarist, me qëllim të krijimit të një klime më të mirë të investimeve. Krijimi i një sistemi të transportit të bazuar në treg, ndërmarrja e hapave të nevojshëm për ta hapur tregun e energjisë dhe sigurimi i furnizimit të besueshëm me energji elektrike janë gjithashtu me rëndësi jetike për konkurrueshmërinë e Kosovës dhe agjentë të rritjes.

Për prioritetet e vitit 2018 në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Promovimi i investimeve të huaja direkte

- Ristrukturimi i Agjencisë për Investime
 - *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria (30 mars 2018)*
- Miratimi i *after-care* programit dhe shërbimeve për investitorët
 - *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (30 shtator 2018)*

2. Përmirësimi i mjedisit afarist

- Miratimi i Ligjit për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim
 - *Ministria e Financave, Qeveria (30 mars 2018)*
- Përditësimi i Regjistrimit Qendror për Leje dhe Licenca
 - *Zyra e Kryeministrit (30 qershor 2018)*
- Miratimi i Ligjit për Inspektimet
 - *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria (30 shtator 2018)*
- Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore dhe funksionalizimi i Komisionit dhe Departamentit për Ndihmë Shtetërore
 - *Ministria e Financave (30 qershor 2018)*
- Zbatimin i Planit të Veprimit për të Luftuar Ekonominë Joformale
 - *Ministria e Financave (30 shtator 2018)*
- Miratimi i pakos ligjore për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë, si dhe funksionalizimi i 4 laboratorëve të metrologjisë
 - *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria (30 shtator 2018)*
- Rekrutimi i gjyqtareve dhe stafit profesional në Departamentin për Çështje Ekonomike dhe Divizionin për Çështje Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës
 - *Këshilli Gjyqësor i Kosovës (30 qershor 2018)*
- Zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara
 - *Ministria e Financave dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (30 shtator 2018)*

3. Statistikat

- Zhvillimi i statistikave sektoriale të biznesit, energjisë dhe atyre sociale
 - *Agjencia e Statistikave të Kosovës (30 shtator 2018)*

4. Agjenda e interkonektivitetit

- Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' në kuadër të agjendës së konektivitetit
 - *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Infrastrukturës, ZRRE dhe KOSTT (30 shtator 2018)*

5. Energjia

- Miratimi i Strategjisë së Energjisë 2017-2026
 - *Kuvendi (30 mars 2018)*
- Miratimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2017-2019
 - *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Qeveria (30 qershor 2017)*
- Investimet e reja në gjenerimin e energjisë
 - *Ministria e Zhvillimit Ekonomik (30 mars 2018)*
- Miratimi i Plani të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
 - *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Qeveria (30 mars 2018)*
- Krijimi i Fondit për Eficiência të Energjisë
 - *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Qeveria (30 qershor 2018)*

III. Punësimi dhe arsimit

Kosova ka një shkallë shumë të ulët të pjesëmarrjes në tregun e punës, në vitin 2016 është 38.7%, me boshllëqe të theksuara ndërmjet meshkujve (58.3%) dhe femrave (18.6%). Shkalla e punësimit në vitin 2016 ishte 28%, shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12.7%, krahasuar me 43.0% për meshkujt. Kështu, shkalla e papunësisë është e lartë 27.5% (26.2%, te meshkujt, 31.8% te femrat). Përfshirja e dobët e të rinjve në tregun e punës përbën brengë të veçantë. Vetëm 10.1% e të rinjve nën moshën 25-vjeçare janë të punësuar.

Kosova i ka 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë, gjë që tejkalon mesataren e Bashkimit Evropian. Megjithatë, ka nevojë urgjente që të reformohet sektori i arsimit dhe që të ndërlihet arsimit dhe aftësimi pas nivelit të mesëm me boshllëqet në tregun e punës. Megjithatë, meqë shkathtësitë themelore dhe 'të buta' zakonisht zhvillohen gjatë arsimit themelor, duhet të përmirësohet cilësia e arsimit parauniversitar.

Për prioritetet e vitit 2018 në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Përmirësimi i mundësive të punësimit, me fokus në punësimin e të rinjve dhe grave:

- Zbatimi i Planit të Veprimit për Punësim dhe Politikën e Sociale
 - *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (30 shtator 2018)*
- Zbatimi i Planit të Veprimit për Punësim e të Rinjve
 - *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (30 shtator 2018)*

2. Përmirësimi i cilësisë së arsimit

- Miratimi i pakos ligjore për reformën në sektorin e arsimit
 - *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria (30 qershor 2018)*
- Rritja e vijueshmërisë në arsimin parashkollor (33.9% në 2016/17)
 - *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (30 shtator 2018)*
- Zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetencë për klasat 0, 1, 2, 6, 7, 11 dhe zhvillimi i kurrikulave për klasat 3, 8 dhe 12
 - *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (30 shtator 2018)*
- Hartimi i 25 standardeve të profesionit dhe rishikimi i 20 kurrikulave të Arsimit dhe Aftësimit Profesional
 - *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (30 shtator 2018)*




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kompensimi financiar i njëhershëm për delegatët e legjislaturës 1990, të cilët kanë certifikuar mandatin e deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, të datës 4 dhjetor 1999, të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës me datën 2 Korrik 1990 dhe me datën 7 Shtator 1990, si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri me datën 24 maj 1992.
2. Mjetet financiare të përcaktuara në Ligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 në vlerë prej 300.000 euro, do të ndahen proporcionalisht për 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë, sipas Gazeta Zyrtare nr. 21 e datës 3 korrik 1990, në shumë prej 2,702.70 euro për secilin deputet.
3. Për ata deputetë që nuk janë në jetë, kompensimin e plotë financiar të njëhershëm, do e gëzojnë bashkëshortja/e veja e deputetit, apo fëmija deri në moshën 18 vjeçare, dhe nëse janë në studime deri në moshën 26 vjeçare, siç është përcaktuar në pikën 2. të këtij vendimi.
4. Çdo vendim për kompensimin e kësaj kategorie të përfituesve, duhet të jetë i bazuar në ndarjen buxhetore të paraparë për këtë qëllim, sipas Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017.
5. Dokumenti në bazë të të cilit vërtetohet numri dhe identiteti (emri e mbiemri) i deputetëve që do ta gëzojnë kompensimin financiar të njëhershëm, sipas pikës 1. të këtij vendimi, është Gazeta Zyrtare nr. 21 e datës 3 korrik 1990.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) 2014-2020".
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me afatin e përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimet mbi të Ardhurat dhe mbi Kapitalin, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, Zonat Kadastrale Doganaj, Soponicë, Rekë, Nikaj, Biqec, Koxhaj, Gajre, Gjurgjedell, Kaçanik, Kaçanik i vjetër, Komuna e Kaçanikut dhe Zonat Kadastrale Paldenicë dhe Pustenik Komuna e Hanit të Elezit, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarin e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko-Privat, në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm, si në vijim:
 - 1.1. Ministri i Financave kryesues;
 - 1.2. Ministri i Zhvillimit Ekonomik anëtar;
 - 1.3. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor anëtar;
 - 1.4. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë anëtar;
 - 1.5. Ministri i Infrastrukturës anëtar.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/15 i datës 25.02.2015.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 290,000 (dyqindëntëdhjetë mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për familjet e shtetasve të Kosovës të vrarë dhe të dënuar në rastin "Kumanova".
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe i barten proporcionalisht secilës familje në shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore Korporata Energetike e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Faruk Hajrizi, kryesues;
 - 1.2. Gjelosh Vataj;
 - 1.3. Mehdi Pllashniku;
 - 1.4. Izet Ibrahim;
 - 1.5. Fllanza Beqiri - Hoxha;
 - 1.6. Ilir Rama.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti në lidhje me Dëshmorët e Kombit, i përgatitur nga Zyra për Çështje të Kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, sipas Listave/Regjistrit të Komisionit Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Dëshmorit të kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të UÇK-së.
2. Lista përfundimtare e verifikimit për të gjitha kategoritë e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-172, si dhe çështjet që ndërlidhen me këtë proces, mbetet të shqyrtohen dhe miratohen në të ardhmen.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/13

Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-92, si dhe Udhëzimet Administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK): Nr. 02/2015, Nr. 05/2016 dhe Nr. 03/2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë që të shfrytëzojë kontratat e lidhura nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik (AQP) për prokurimet e centralizuara, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, si dhe Udhëzimet Administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK): Nr. 02/2015, Nr. 05/2016 dhe Nr. 03/2017 dhe të janë pjesë e këtyre UA.
2. AQP-së i lejohet të vendosë që një aktivitet i prokurimit i cili është pjesë e Udhëzimit Administrativ, mund të zhvillohet nga ndonjë apo disa Autoritete Kontraktuese për kohë të caktuar nëse për shkaqe dhe arsye të qëndrueshme konsiderohet e arsyeshme. Në raste të tilla, AQP do të njoftojë Institucionet kompetente ashtu siç parashihet me UA.
3. Çdo kontratë e lidhur në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe pa miratim të AQP-së do të shpallet e pa vlefshme gjatë periudhës së ardhshme për periudhën sa është në fuqi kontrata e lidhur nga AQP.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik (AQP) që ta zbatojnë këtë vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/13
Datë: 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, me Rregulloren nr. 14/2017 dhe me Rregulloren nr. 15/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Kërkohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) që për periudhën një (1) vjeçare të pezullojë procesin e privatizimit të pasurive të paluajtshme (tokave) që janë nën menaxhimin e saj.
2. Obligohet AKP që ta zbatojë vendimin e Qeverisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë